



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Akademia e Drejtësisë - Akademija Pravde - Academy of Justice

---

# Buletini informativ

- **Aktivitetet e përgjithshme**
- \* **Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)**
- \* **Aktivitetet nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)**
- \* **Aktivitetet për stafin administrativegjyqësor dhe prokurorial**
- \* **Aktivitetet për profesionistët tjerë ligjor**
- \* **Trajnimi i Trajnuesve**

**Prill 2022**

## Aktivitetet e përgjithshme

### Drejtori Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë merr pjesë në Forumin për Barazi Gjinore për Ballkanin Perëndimor

Prishtinë, 4 prill 2022 – Me ftesë nga Qendra AIRE, Drejtori i Akademisë së Drejtësisë z. Enver Fejzullahu së bashku me Kryetarin e Gjykatës Supreme Enver Peci, Kryesuesin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), Albert Zogaj, dhe Kryetaren e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Albina Shabani-Rama, kanë marrë pjesë në Forumin e parë të Barazisë Gjinore për Ballkanin Perëndimor, i cili u mbajt këtë fundjavë në Mal të Zi.

Pjesë e këtij forumi ishin edhe Presidenti i Gjykatës Evropiane, Robert Spano, zëvendës presidentja e Gjykatës, Siofra O’Leary, gjyqtarë të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe gjyqtarë e ekspertë nga rajoni.

Në këtë forum, u diskutua lidhur me luftimin e

dhunës ndaj grave dhe vajzave përmes promovimit të barazisë gjinore dhe Konventa Evropiane për të Drejta të Njeriut (KEDNj), barazisë gjinore dhe KEDNj – ndërveprimi ndërmjet nenit 8 dhe nenit 14 të KEDNj-së, dhuna në familje dhe dhuna me bazë gjinore dhe KEDNj-ja.

Forumit mbledhi bashkë përfaqësues të gjykatave kushtetuese dhe supreme, ombudspersonë, përfshirë edhe kryetaren e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Gresa Cakanimanin, Avokatin e Popullit të Kosovës, Naim Qela dhe gjyqtarë që trajtojnë rastet e dhunës në familje dhe barazisë gjinore.



## **Drejtori Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë priti në takim Prof.Dr.Ismet Salihun**

---

Më 06 prill 2022, Drejtori Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë, Enver Fejzullahu, pati kënaqësinë që të pres në një takim të përzemërt profesorin e nderuar Prof. Dr. Ismet Salihu.

Në këtë takim, Prof. Dr. Ismet Salihu, ia dhuroj Drejtorit Ekzekutiv të AD-së një ekzemplarë të veprës së tij të sapo botuar me dimension enciklopedik “Leksikon i së Drejtës Penale”, duke theksuar se është i pari i këtij lloji në Kosovë, i cili iu dedikohet studentëve të fakulteteve juridike, gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve dhe juristëve të tjerë të cilëve në punën e tyre profesionale u nevojiten informacione nga fusha e së

drejtës penale.

Me këtë rast, z. Fejzullahu falënderoi profesorin e nderuar për dhurimin e këtij Leksikoni, por edhe për kontributin e tij të jashtëzakonshëm shumë vjeçar në shkencat juridike dhe në përgjithësi në sistemin e drejtësisë në Kosovë, duke vlerësuar Leksikonin si një resurs të vlefshëm për gjyqtarët, prokurorët dhe profesionistët tjerë gjyqësor që punojnë në institucionet e zbatimit të ligjit



## **Drejtori Ekzekutiv pret në takim shefin e Misionit të EULEX-it z. Lars-Gunnar Wigemark**

---

Më 21 prill 2022, Drejtori Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë, Enver Fejzullahu, ka prituri në takim Shefin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë EULEX, z. Lars-Gunnar Wigemark.

Gjatë këtij takimi, dy bashkëbiseduesit kanë diskutuar për nevojën e avancimit të bashkëpunimit dhe përpjekjeve të përbashkëta në funksion të forcimit të sundimi të ligjit në Republikën e Kosovës.

Fillimisht, z. Fejzullahu, e njoftoi shefin e EULEX-it me punën e Akademisë së Drejtësisë, për sfidat dhe objektivat e këtij institucioni, si dhe shprehu gatishmërinë për bashkëpunim në proceset e interesit të përbashkët mes EULEX-it dhe AD-së.

Nga ana tjetër, z. Wigemark, shprehu përkrahjen

e tij për të vazhduar bashkëpunimin me Akademinë e Drejtësisë në ngritjen e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe stafit të AD-së, duke ofruar resurset që ka EULEX-i, me qëllim të shkëmbimit të eksperiencave në fusha të ndryshme, me theks të veçantë lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me krimet e luftës, komunikim me publikun si dhe tema të tjera me interes për përfituesit dhe stafin e AD-së.

Të dy bashkëbiseduesit më tutje u pajtuan për ta zhvilluar më tej bashkëpunimin ndër-institucional në fuqizimin dhe avancimin e sistemit të drejtësisë në Kosovë.



## **Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve Fillestare**

### **Përgatitja e raporteve përfundimtare për 24 gjyqtarët e gjeneratës së VIII për KGJK si dhe përgatitjet për trajnim fillestar për gjeneratën e IX të gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj**

---

Gjatë muajit prill aktivitetet e këtij programi kanë qenë të orientuara në përgatitjen e dosjeve me raportet përfundimtare të 24 gjyqtarëve të gjeneratës së VIII të cilët kanë përfunduar trajnimin fillestar në Akademi të Drejtësisë. Me 8 prill është bërë pranim dorëzimi i dosjeve në Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Aktivitetet tjera në këtë program kanë qenë të fokusuar në përgatitjet paraprake për programin trajnues për gjeneratën e IX të gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj të cilët pritet

së shpejti të dekretohen pasi janë përfunduar gjitha fazat e rekrutimit nga KGJK dhe KPK.

Meqenëse programi trajnues për këtë gjeneratë të gjyqtarëve dhe prokurorëve është miratuar nga Këshilli Drejtues, Akademia e Drejtësisë ka filluar me procesin e hartimit dhe përditësimit të moduleve trajnuese.

## Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

### Trajnimi: Provat në procedurën penale, Masat e fshehta të hetimit dhe vëzhgimit si dhe Mbrojtja e dëshimtarëve dhe të dëmtuarve si dhe dëshimtarët bashkëpunues – Sesioni II

---

Më 05 Prill 2022, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme ka realizuar trajnimin përmes platformës Zoom me temë “Provat në procedurën penale, Masat e fshehta të hetimit dhe vëzhgimit si dhe Mbrojtja e dëshimtarëve dhe të dëmtuarve (viktimave) si dhe dëshimtarët bashkëpunues – Sesioi II”.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte të rris kapacitetin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në zërthimin e provës, relevancën dhe besueshmërinë e provës si parakusht për zgjidhjen e drejtë dhe meritore të rasteve përkatëse.

Trajnimi është fokusuar në trajtimin e aspektit material dhe procedural të masave të fshehta, llojeve të tyre duke vënë në pah veprat penale për të cilat mund të lëshohen këto masa, kur lëshohen masat e fshehta, cilat janë bazat e dyshimit. Më tej trajnimi është vazhduar me sqarimet rreth kërkesës për lëshimin e urdhrit për masat e fshehta, përdorimin e masave të fshehta si provë në procedurë penale, kohëzgjatjen e masave të fshehta, pranueshmërinë e provave të siguruara me anë

të urdhrit për masat e fshehta dhe teknike të hetimit dhe vëzhgimit dhe Paneli për shqyrtimin e Vëzhgimit dhe Hetimit Gjithastu vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe të drejtave të personave ndaj të cilëve zbatohen urdhëresa për masa të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit.

Pjesëmarrësit patën rastin që përmes rasteve të ndryshme nga praktika gjyqësore të zërthejnë dispozitat ligjore që rregullojnë masat e fshehta të hetimit dhe vëzhgimit si dhe aspekte tjera procedurale me rëndësi në mënyrë që të zbatohen drejtë gjatë hetimit dhe gjykimit të kryesve të veprave penale.

Metodologjia e zbatuar ishte e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 8 gjyqtarë ( 1 nga Gjykata e Apelit dhe 7 gjyqtarë nga Gjykatat Themelore), 11 prokuror kryesisht nga niveli themelor si dhe 1 zyrtarë policor nga Policia e Kosovës.



## **Trajnim: Procedura gjyqësore në rastet mbrojtjes nga dhuna në familje me theks të veçantë në llojet e masave, zbatimin dhe pasojat-civile**

Më 06 Prill 2022, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme ka realizuar trajnimin me temë “Procedura gjyqësore në rastet e mbrojtjes nga Dhuna në Familje, me theks të veçantë në llojet e masave, zbatimin dhe pasojat

Qëllimi i këtij trajnimi ishte rritja e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe aktërëve tjerë relevantë për procedurën në rastet e dhunës në familje dhe që brenda afateve ligjore t’iu përgjigjen nevojave të viktimave dhe të caktojnë masat e duhura ligjore për mbrojtje dhe parandalim.

Trajnimi fillimisht është fokusuar me pjesën teorike për shkak të keqkuptimeve, keqinterpretimeve të nocioneve sipas Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje. Veçanërisht është trajtuar dhuna në familje dhe llojet e saj, urdhri për mbrojtje, kërkesa për urdhër mbrojtje dhe përmbajtja e saj, procedura gjyqësore për vendosje sipas kërkesave për urdhër mbrojtje, llojet e masave mbrojtëse dhe kohëzgjatja e tyre, ekzekutimi dhe pasojat e ekzekutimit të

urdhrit për mbrojtje si dhe qasja ndaj dhunës në familje sipas Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Pjesëmarrësit patën rastin që përmes rasteve të ndryshme nga praktika gjyqësore të cilat janë identifikuar me probleme ligjore nga ana e Gjykatës së Apelit të eliminojnë problemet teorike dhe praktike për rastet e reja në të ardhmen

Metodologjia e zbatuar ishte e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 24 gjyqtarë ( 1 nga Gjykata Supreme, 3 nga Gjykata e Apelit dhe 20 të tjerë nga Gjykatat Themelore) 3 zyrtarë policor, 2 zyrtarë për mbrojtje dhe ndihmë viktimave si dhe 2 bashkëpunëtorë profesional nga gjykatat.



## Trajnim/Punëtori për përmirësimin e praktikës gjyqësore ndërmjet prokurorëve dhe gjyqtarëve

Me 13-14 prill 2022, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Ambasadën Amerikane OPDAT ka realizuar punëtorinë dy ditore për përmirësimin e praktikës gjyqësore ndërmjet prokurorëve dhe gjyqtarëve.

Qëllimi i kësaj punëtorie ishte përmirësimi i cilësisë së akteve akuzuese, kërkesave dhe urdhrat për masat e fshehta të hetimit dhe vëzhgimit për gjykimin e drejtë të rasteve të pastrimit të parave, krimit të organizuar dhe veprave tjera penale të ndihmës dhe bashkimit kriminal dhe e harmonizimin e praktikës gjyqësore për çështjet e lartpërmendura.

Në ditën e parë trajnimi u fokusua në mënyrën e hartimit të aktakuzës duke eliminuar mangësitë e zakonshme të vërejtura nga gjyqtarët, në kërkesën/urdhrit për masa të fshehta-përmbajtjen e saj dhe specifikat tjera duke interpretuar saktë dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me masat e fshehta. Në vazhdim është diskutuar për ekzaminimin e bisedave nga aplikacionet e komunikimit si Viber, Whats App si përgjim i komunikimeve ose ekzaminim i paisjeve

elektronike të sekuestruara, për hetimet financiare dhe pastrimin e parave, përkatësisht mjaftueshmërinë e provave dhe a mund të akuzohet si vepër e pavarur apo është i domosdoshëm ekzistimi i veprës penale bazë, si dhe për rastet e krimit të organizuar duke eliminuar dilemat rreth interpretimit të duhur të dispozitave përkatëse dhe për urdhrat e konfiskimit.

Në ditën e dytë u diskutua për të drejtën për të mos u ndëshkuar, cilësinë e aktgjykimeve, legjislacionin në fuqi për krimet e luftës, gjykimin në mungesë, dëshmitarët bashkëpunues, dashjen direkte përballë asaj indirekte duke vënë në pah praktikën jokonsistente të gjykatave por edhe dilemat në rastet përkatëse.

Pjesëmarrës në këtë punëtori ishin 7 gjyqtarë nga Departamenti Special i Gjykatës Themelore si dhe 14 prokuror ( 13 nga Prokuroria Speciale dhe 1 nga Prokuroria Themelore)





## Trajnim: Veprat penale kundër mjedisit

Me 14 prill 2022, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me GIZ ka realizuar trajnimin me temë: “Veprat penale kundër mjedisit”

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me legjislacionin vendor dhe ndërkombëtar për mbrojtjen e mjedisit dhe interpretimi dhe zbatimi i drejtë i dispozitave përkatëse në praktikën gjyqësore të veprave penale kundër mjedisit.

Trajnimi fillimisht është fokusuar me pjesën teorike të nocioneve të ndotjes, degradimit ose shkatërrimit të mjedisit, shkatërrimit të botës bimore me materie të dëmshme si dhe shkretërimin e pyjeve. Në vazhdim është fokusuar me përkufizimin dhe elementet esenciale të veprave penale kundër mjedisit, rrethanat, mënyrat dhe format e kryerjes dhe problemet praktike me rastin e kualifikimit.

Gjatë trajnimit pjesëmarrësit patën rastin e diskutimit të rasteve nga praktika dhe në këtë

mënyrë edhe të qartësojnë dispozitat ligjore adekuate. Po ashtu si ilustrim u përdoren edhe disa raste nga praktika e GJEDNJ-së e cila pavarësisht “mungesës” të një rregullimi të përcaktuar shprehimisht për mjedisin i ka dhënë zgjidhje çështjeve përkatëse duke zbatuar në nenet e Konventës që përfshijnë rregullime të përgjithshme lidhur me mbrojtjen dhe gëzimin e të drejtave themelore duke përfshirë këtu edhe mbrojtjen e mjedisit dhe të drejtën për të pasur një mjedis të pastër e cila lidhet drejtpërdrejtë me të drejtën për të gëzuar jetën private, pronën, familjen etj.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 3 nga Gjykatat Themelore, 4 prokuror nga Prokuroritë Themelore, 5 inspektor nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor si dhe 3 zyrtarë policor.



## Trajnimi: Njohja dhe përmbarimi i vendimeve të Tribunalit të Arbitrazhit vendor dhe të huaj

Më 19 Prill 2022, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me USAID / Drejtësia Komerciale, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, kanë realizuar trajnimin me temë “Njohja dhe përmbarimi i vendimeve të Tribunalit të Arbitrazhit vendor dhe të huaj”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me procedurën e njohjes dhe përmbarimit të vendimeve të arbitrazhit si ato vendore ashtu edhe të huaja dhe unifikimi i praktikës në përmbarimin e këtyre vendimeve.

Trajnimi fillimisht u fokusua në rolin e formave alternative të zgjidhjes së kontesteve me theks te Arbitrazhi dhe Ndërmjetësimi në radhë të parë për sigurinë juridike dhe mundësinë e tërheqjes së investimeve të huaja aq të nevojshme për zhvillimin e ekonomik e më pas u diskutua për procesin e njohjes së vendimeve të arbitrazhit, përmbarimin e vendimeve të arbitrazhit të nxjerra nga

Tribunalet e Arbitrazhit brenda dhe jashtë Kosovës.

Gjatë këtij trajnimi pjesëmarrësit patën rastin e studimit dhe analizimit të një rasti praktik përmes të cilit u sqaruan aspekte të rëndësishme që gjyqtarët hasin gjatë procedurës së njohjes dhe përmbarimit të vendimeve të arbitrazhit. dilema sa i përket adresoiu trajtuan temat: Procesi i njohjes së vendimeve të arbitrazhit; Përmbarimi i, Unifikimi i praktikës së njohjes së arbitrazhit dhe Rast praktik.

Metodologjia e zbatuar ishte e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 9 gjyqtarë, prej tyre 2 gjyqtarë nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme dhe 7 gjyqtarë nga Gjykata Themelore nga të gjitha regionet e Kosovës.



## Punëtori për mjetet forezike kibernetike

Me datë 21-22 prill 2022, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Ambasadën Amerikane OPDAT ka realizuar dy (2) punëtori me temë: “Mjetet Forezike Kibernetike”.

Qëllimi i këtyre punëtorive ishte që prokurorët të diskutojnë dhe avancojnë njohuritë e tyre në përdorimin e mjeteve forezike me qëllim të ndjekjes penale të suksesshme, me theks të veçantë në rastet e korrupsionit.

Punëtorja e parë është realizuar me prokurorët e Prokurorisë Speciale, ndërkaq në punëtorinë e dytë janë përfshirë prokurorët nga Prokuroritë Themelore.

Në të dy punëtoritë vëmendje e veçantë i është kushtuar mjeteve forezike kibernetike, zbulimit, analizimit dhe organizimit të provave kibernetike, përkatësisht dëshmime të marra nga kompjuteri personal, dëshmitë nga interneti si dhe përfshirjes së këtyre provave në gjykatë.

Në punëtorinë e parë përfitues ishin 8 prokurorë nga Prokuroria Speciale si dhe 2 zyrtarë ligjor nga kjo prokurori, ndërkaq në punëtorinë e dytë përfitues ishin 15 prokurorë nga Prokuroria Themelore në Prishtinë.



## Trajnim: Qasja dhe përdorimi i rregulltë i Sistemit Qendror të Evidencës Penale në Kosovë

Me 26-27 Prill 2022, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë: “ Qasja dhe përdorimi i rregullt i Sistemit Qendror të Evidencës Penale.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte ngritja e kapaciteteve profesionale e gjyqtarëve dhe akterëve tjerë përgjegjës në përdorimin e pavarur dhe të rregulltë të SQEPK përkatësisht nxjerrjen e të dhënave dhe kontrollimin e evidencës penale të personit fizik dhe juridik për qëllimet e procedurës penale.

Trajnimi fillimisht është fokusuar në shpjegimin teorik të rolit dhe rëndësisë së SQEP, duke përkujtuar se të dhënat që futen në këtë data bazë duhet të jenë të sakta, korrekte dhe të plota. Vëmendje e veçantë i është kushtuar të dhënave te ndjeshme, pastaj autoritetet që kanë të drejtë të marrin ekstrakte nga evidenca penale. Me rastin e këtij trajnimi u fol edhe për parimet që rregullojnë të drejtën për qasje në informata lidhur me evidencën penale personale, komunikimin e informacionit dhe përdorimin e tij, parimet që rregullojnë të drejtën për qasje në informata lidhur me evidencën penale personale nga autoritetet gjyqësore, udhëzimet në lidhje me evidencën penale në lidhje me të miturit si dhe mbrojtjen e evidencës penale gjatë procedurës penale si dhe parimet që rregullojnë rehabilitimin, shlyerjen, amnistinë dhe faljen.

Përveç nga këndvështrimi i Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, qasja dhe përdorimi i rregulltë i SQEP u theksua që duhet të jetë në pajtim edhe me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale duke elaboruar veq e veq konceptet themelore të këtij ligji e gjithashtu Ligjit për sigurimin e informacionit dhe klasifikimin e informacionit.

Në ditën e dytë trajnimi u përqendrua në kornizën vendore dhe ndërkombëtare me fokus te praktika evropiane që rregullon njohjen e vendimeve të huaja në Kosovë duke përfshirë edhe Rregulloren e KGJK-së dhe parimet kryesore për SQEPK. Në vazhdim janë trajtuar edhe aspekte tjera si mandati i SQEPK-së, struktura organizative, funksionet, menaxhimi të sistemit, të dhënat personale të personave të dënuar, llojet e akteve që mund ti gjenerojë kjo databazë si dhe detaje tjera të rëndësishme.

Në fund të trajnimit pjesëmarrësit e trajnimit patën rastin e demonstrimit praktik të përdorimit dhe funksionimit të SQEPK me fokus te procesi i identifikimit, mënyrat e kërkimit të një personi të dënuar duke përfshirë të gjitha modulet e veçanta që përmbanë kjo platformë që akterëve përgjegjës t’iu lehtësohet përdorimi dhe marrja e të dhënave nga SQEPK.

Këtë trajnim e kanë vijuar 5 gjyqtarë dhe 1 prokurorë kryesisht të nivelit themelor.





## Aktivitetet për stafin administrative gjyqësor dhe prokurorial

### Trajnimi: Pjesa e përgjithshme dhe e posaçme e së drejtës penale, Grupi II

---

Më 13-15 prill 2022, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me UNDP, ka vazhduar me realizimin e 3 trajnimeve nga Moduli Bazik për bashkëpunëtor profesional dhe zyrtar ligjor për Grupin e II-të me temë “Pjesa e përgjithshme dhe e posaçme e së drejtës penale”.

Për të mundësuar pjesëmarrjen në trajnime të gjithë bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor të gjykatave dhe prokurorive që punojnë në fushën penale, Akademia e Drejtësisë i ka ndarë në 4 grupe.

Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte avancimi i njohurive të bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor të gjykatave dhe prokurorive lidhur me kornizën ligjore në fushën penale dhe zbatimin e drejtë në praktikën gjyqësore për zgjidhjen meritore të rasteve.

Në kuadër të këtyre sesioneve trajnuese nga pjesa e përgjithshme e së drejtës penale u diskutua për parimet e përgjithshme në zbatimin e Ligjit më të favorshëm me fokus te vlerësimet lidhur me zbatimin e ligjit më të favorshëm, pastaj për veprat penale, elementet, mënyra e kryerjes, koha dhe vendi i kryerjes së veprës penale. Në vazhdim është diskutuar edhe për shkaqet e përjashtimit të kundërligjshmërisë me theks te mbrojtja e nevojshme, nevoja ekstreme, dhuna dhe kanosja, vepra e rëndësisë së vogël dhe përgjegjësia penale.

Në kuadër të pjesës së posaçme është diskutuar për veprat penale kundër jetës dhe trupit me theks te vrasja dhe vrasja e rëndë si dhe për veprat penale kundër integritetit seksual duke trajtuar me vëmendje të veçantë aspekte të rëndësishme të dhunimit dhe sulmit seksual.

Gjatë trajnimit, pjesëmarrësit patën rastin që përmes rasteve të shumta studimore të bashkëpunimit në kryerjen e veprave penale dhe ndihmës në kryerjen e veprave penale të diskutojnë dhe të japin opinione ligjore dhe njëkohësisht të zërthejnë dispozitat ligjore.

Në trajnimin e parë kanë marrë pjesë 38 pjesëmarrës, të gjithë bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor nga Gjykata dhe Prokuroria. Nga Prokuroritë ishin gjithësejt 25 ndërsa nga gjykatat 13. Sa i përket përkatësisë etnike 36 pjesëmarrës ishin shqiptarë, 2 pjesëmarrës ishin nga komuniteti jo shumicë serb. Në aspektin gjinor 23 pjesëmarrës ishin femra dhe 15 pjesëmarrës ishin meshkuj.

Në trajnimin e dytë këtë trajnim kanë marrë pjesë 38 bashkëpunëtorë profesional nga gjykatat dhe prokuroritë, 1 prej tyre ishte mbrojtës i viktimave. Nga Gjykatat ishin 12 bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor ndërkaq nga Prokuroria 24. Sa i përket përkatësisë etnike 36 pjesëmarrës ishin shqiptarë, 2 pjesëmarrës ishin nga komuniteti jo shumicë serb. Në aspektin gjinor 23 pjesëmarrës ishin femra dhe 15 pjesëmarrës ishin meshkuj.

Në trajnimin e tretë kanë marrë pjesë 37 bashkëpunëtorë profesional nga gjykatat dhe prokuroritë, 1 prej tyre ishte mbrojtës i viktimave. Nga prokuroria ishin 22 ndërkaq nga gjykatat 14 .Sa i përket përkatësisë etnike 35 pjesëmarrës ishin shqiptarë, 2 pjesëmarrës ishin nga komuniteti jo shumicë serb. Në aspektin gjinor 22 pjesëmarrës ishin femra dhe 15 pjesëmarrës ishin meshkuj. Përfitues të trajnimit ishin: Staf administrativ nga Gjykata dhe Prokuroria.



## Trajnimi: Integriteti dhe sjelljet etike

---

Me 21 prill 2022, për stafin administrativ të Gjykatave dhe Prokurorive është realizuar trajnimi me temë: “Integriteti dhe sjelljet etike”. Qëllimi i këtij trajnimi ishte rritja e kapaciteteve të stafit administrativ për sjelljet etike brenda dhe jashtë zyrës në pajtim me parimet dhe normat e sjelljes etike.

Fillimisht trajnimi startoi me parimet dhe normat themelore të etikës si dhe sjelljet brenda dhe jashtë zyrës me theks me parimin e ligjshmërisë, sinqeritetit dhe ndershmërisë si dhe parimin e respektimit.

Më pastaj trajnimi ka vazhduar me pjesën e dytë me ndërgjegjësimin social dhe përgjegjësinë e stafit në punë, me fokus të veçantë te ngacmimet e natyrave të ndryshme brenda objektit të punës, shmangies nga konflikti i interesit, veprimtarisë politike dhe ndërveprimi i saj në punën ditore etj.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 17 staf administrativ, përkatësisht referentë, zyrtarë ligjor, zyrtar të arkivave dhe financave nga Gjykatat dhe Prokuroritë e Kosovës.



## Aktivitetet për profesionistët tjerë ligjor

### Trajnimi: Përmbarimi përmes llogarive bankare

---



Me 28 prill 2022, Akademia e Drejtësisë, në bashkëpunim me The Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ), në vazhden e organizimit të trajnimeve për Profesionet e lira, ka realizuar trajnimin për Përmbaruesit Privat me temë: “Përmbarimi përmes llogarive bankare - unifikimi i akteve”.

Qëllimi i trajnimit ishte që pjesëmarrësit të unifikojnë veprimet e tyre në rastet e përmbarimit përmes llogarive bankare, si dhe të diskutojnë problemet praktike që i hasin gjatë punës së përditshme dhe për të njëjtat të ofrohen zgjidhjet e duhura ligjore.

Gjatë trajnimit u diskutuan aspekte të

rëndësishme nga përmbarimi i detyrueshëm, sekuestrimi dhe përmbarimi në llogarinë bankare, për radhën e pagesave, pagesat periodike, veprimet në rastet kur nuk ka mjete në llogari të debitorit, veprimet në rast të pengesave për kryerjen e përmbarimit, përmbarimin ndaj debitorit me përgjegjësi solidare.

Gjithashtu u trajtuan edhe çështjet e përmbarimi në disa llogari, përmbarimi për mjetet në llogarinë devizore dhe në valutë të huaj.

Pjesëmarrësit patën mundësinë që çështjet e përmendura ti diskutojnë dhe zbërthejnë përmes rasteve studimore dhe në këtë mënyrë edhe ti njohin praktikat më të mira në këtë fushë.

Përfitues të trajnimit ishin 14 përmbarues privat nga regjione të ndryshme të Kosovës.



## Aktivitetet për trajnues

### Trajnimi i trajnuesve—Financimi i terrorizmit ( faza II )

Më 07 prill 2022, Akademia e Drejtësisë, në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, projekti i PECK III, ka realizuar fazën e II-të të Trajnimit të Trajnuesve në fushën e Financimit të Terrorizmit.



Ky trajnim, vije si vazhdimësi e trajnimit paraprak të realizuar gjatë tetorit të vitit 2021, me ç'rast është krijuar një grup prej rreth 15 trajnuesish potencial në fushën e terrorizmit, duke përfshirë Gjyqtarë, Prokurorë, zyrtarë nga Njësia e Inteligjencës Financiare si dhe zyrtarë nga Policia e Kosovës.

Trajnimi për dy ditë me radhë ishte e dizajnuar më shumë në prezantimet e grupeve trajnuese të ndara paraprakisht nga eksperti ndërkombëtarë

z. Theo Byl.




Prezantimet nga trajnuesit kanë qenë të fokusuara në tema specifike si: Kornizën ndërkombëtare mbi terrorizmin dhe financimin e terrorizmit, metodat dhe teknikat e financimit të terrorizmit, kornizën ligjore në Kosovë për çështjet e financimit të terrorizmit, mbledhjen e dëshmive, koordinimin nacional dhe ndërkombëtarë ndihmën juridike të ndërsjellë dhe ekipet e përbashkëta hetimore, kthimin e aseteve dhe në fund një simulim i të rastit .

Në fund, i gjithë grupi i trajnuesve vendorë ka tmarrë rekomandime, këshilla dhe vlerësimin përfundimtar nga eksperti z. Byl, fazë e cila do i paraprijë çertifikimit të grupit të pjesëmarrësve.

Këtë trajnim e vijuan 4 gjyqtarë, 2 prokuror, 2 nga Njësia e Inteligjencës Financiare, 1 ligjërues nga Akademia për Siguri Publike dhe 8 zyrtarë policor nga radhët e mbikëqyrësve, hetuesve, shëf i njësive dhe mbikëqyrës nga Policia e Kosovës.




## Vijueshmëria në trajnime në PTV e shfaqur përmes grafikoneve




## Vijueshmëria në trajnime në PTV përmes grafikoneve


Pjesëmarrja sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike- Prill 2022




Nr. i trajnimeve për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive Prill 2022



Nr. i trajnimeve të realizuara për Profesionet e lira - Përmblyesit Privat Prill 2022



Nr. i trajnimeve dhe i pjesëmarrjes në TIT-Prill 2022





# **Akademia e Drejtësisë**

<https://ad.rks-gov.net>

[infoad@rks-gov.net](mailto:infoad@rks-gov.net)

Rr. "Muharrem Fejza"-Prishtinë

Tel:+383 38 200 18 660